



LISTA KONTROLLUESE E PUNËDHËNSIT PËR VET INSPEKTIM

PJESA 2:	RREZIKET NË PUNË
Tema 2.6.	RREZIKET QË LIDHEN ME AKSIDENTET NË PUNË
Nën – tema 2.6.8.	PUNA ME MJETET DHE PAJISJET E RREZIKSHME
Ligji / rregulloret përkatëse:	• Ligji Nr.04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë; • Ligji Nr.04/L-012 për Mbrojtje nga Zjarri; • Rregullore (MPMS) Nr.05/2014 Kërkesat minimale për përdorimin e pajisjeve të punës; • Rregullore (MPMS) Nr.04/2014 Kërkesat minimale për SSHP; • Rregullore (MPMS) Nr.01/2020 Kërkesat minimale për SSHP; • Rregullore (MPMS) Nr.02/2020 Kërkesat minimale për përdorimin e pajisjeve të punës; • Rregullore (MPMS) 02/2016 Kriteret minimale për pajisje personale mbrojtëse; • Rregullorja (MPMS) Nr.02/2016 Kërkesat minimale për sigurimin e shenjave të SSHP; • Rregullore (MEPTINIS) Nr.02/2020 për Sigurinë e Makinerive; • Rregullore Nr.05/2018 për Sigurinë e Ashensorëve në Përdorim; • Direktivë 2006/42/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit.
Shkurtesa:	• MPMS - Ministria e Punëve dhe Mirëqenjes Sociale • SSHP - Siguri dhe Shëndet në Punë • MEPTINIS - Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësive dhe Investimeve Strategjike • PPM - Pajisjet Personale Mbrojtëse
Përdorimi i listës kontrolluese	Nëse përgjigjeni “Po” në një pyetje, ju lutemi kaloni në pyetjen tjetër, në rast se përgjigjeni “Jo” bëni vërejtje se mund të ndërmerren veprime për të përmbushur kërkesat ligjore.

Nr.	Pika kontrolli	Po	Jo	Koment për zbatimin
	INSPEKTIMI I VENDPUNISHTEVE / VENDEVE TË PUNËS			
	- Gjatë vizitës në vendet e punës, do t’ju duhet të mbani shënime. Është më e lehtë të mbahen shënime të strukturuar. Për shembull, përdorni formularët e inspektimit. Përmbajtja e formularëve të inspektimit varet nga vendi i punës që do			


	<i>të vizitoni. Nëse nuk keni formularë inspektimi, mbani vetë shënime të mira dhe lehtësisht të kuptueshme (p.sh. duhet të përfshihet vendi i inspektimit, data/ora, ekipi i inspektimit dhe të punësuarit e inspektuar, PPM-të që kërkohen për të kryer detyrën/punën, etj.).</i> <i>- Kushtoni vëmendje, a janë duke u rrespektuar rregullat e shendetit dhe sigurisë në vendin e punës. Pajisjet e punës të vëna në dispozicion të punëmarrësve, a mirëmbahen dhe punohet me ta sipas udhëzimeve dhe procedurave të vëna në dispozicion.</i> <i>- Pajisjet e punës me rrisqe të veqanta, a përdoren vetëm nga persona me kualifikimin i cili është zgjedhur për këtë punë.</i> <i>- Pajisjeve ngritëse të instaluar në mënyrë të përhershme / permanente a u kushtohet rëndësia e duhur. A rrespektohen masat për të shmangur apo zvogëluar riskun e goditjes nga ngarkesat gjatë ngritjes.</i> <i>- Instalimet dhe pajisjet elektrike, a përdoren në përputhje me normat specifike në mënyrë të tillë që të mos shkaktoj rrezik për zjarr dhe shpërthime.</i> <i>- Përveq shënimeve gjatë vizites, bëni edhe fotografi ndaj praktikave të mira, dhe jo të mira.</i> <i>- Jepni shembullin tuaj, përdorni PPM-të në mënyrë të përshtatshme në lokacion / vendet e punës.</i> <i>Bisedoni me punonjësit në mënyrë miqësore dhe u shpjegoni dhe këshilloni atyre mbi rregullat e përgjithshme dhe rëndësinë e respektimit të masave mbrojtëse.</i>			
1.	A janë pajisjet e punës të përshtatshme në vendin e punës dhe përdoren në mënyrë të sigurtë nga punëmarrësit? Rregullore MPMS Nr.05/2014, neni 4, 5, shtojca 1 dhe 2. Rregullore MPMS Nr.02/2020 kërkesat min për SSHP, neni 3. Rregullore (MEPTINIS) Nr.02/2020 për sigurinë e makinerive, neni 9, 14. <i>- Sigurohu që gjatë punës i kushtohet vëmendje pajisjeve të punës të cilat janë përzgjedhur për kryerjen e punëve specifike, diskutoni me punëmarrësit, për qështjet ergonomike dhe mirëmbajtjen e pajisjeve, nëse ato paraqesin rrezik largohen dhe zëvendësohen me pajisje të përshtatshme.</i> <i>- Verifikoni nëse procedurat e sigurisë zbatohen plotësisht në mënyrë strikte, në veqanti me ata pajisje ku përdorimi i tyre nuk mund të kryhet plotësisht pa</i>			

	<i>rreziqe. Diskutoni me punëmarrësit dhe këshilloni ato, nëse kanë nevojë për trajnime apo ri-trajnim.</i> - <i>Pajisjet e punës duhet të jenë në përputhje me kërkesat minimale të përcaktuara në shtojcën 1 dhe 2 të rregullores 05/2014 të MPMS si dhe legjislacionin në fuqi mbi konformitetin e makinerive dhe pajisjeve të tjera teknike, Sigurohu që të gjitha pajisjet dhe mjetet e punës janë komformë kushteve minimale për punë të sigurtë me ta. Verifikoni të gjitha pajisjeve nëse i plotësojnë kushtet sipas rregulloreve në fuqi?</i>			
2.	Pajisjet e instaluar të punës, a garantojnë kushte të sigurtë për punë? Rregullore MPMS Nr.05/2014, neni 6, shtojca 2 pika 5.1.5. Rregullore MPMS Nr.02/2020 kërkesat min për SSHP, neni 4. Shtojca V. - <i>Sigurohu që pajisjet e instaluar për herë të parë, zhvendosjet e pajisjeve bëhen komform rregulloreve dhe udhëzimeve të prodhuesit, raportet e testimit dhe trajnimit të stafit për punë me ato pajisje ruhen si dokumentacion në arkivë.</i> - <i>Nëse pajisja e punës i ekspozohet kushteve që mund të shkaktojnë përkeqësim dhe situatë të rrezikshme, sigurohet kontrollë periodike nga persona kompetent të cilët garantojnë funksionalitetin e sigurtë të pajisjeve. Vëmendje i kushtohet edhe stabilitetit të pajisjeve, mburojat e sigurisë, pastërtisë. Rezultatet e testimeve periodike mbahen në arkivë.</i> - <i>Pajisjet e përzgjedhura për punë në lartësi dhe ngritje duhet të kenë një konfigurim të përshtatshëm dhe fortësi të mjaftueshme për të parandaluar ose ndaluar rënjet nga lartësitë (në rast se identifikoni vende me risk, kërkoni shkakun e tyre, diskutoni me stafin mbase mund të merren disa masa teknike ose organizative për ta shmangur këtë risk.).</i> - <i>A janë instaluar në vendin e punës shenja paralajmëruese, ndaluese dhe obligative, shiko më poshtë disa shenja.</i>			

	 Ngarkesa mbi kokë   Shenja per lokacionet e rrezikshme përplasja me pengesa apo rënje e objekteve			
3.	A përdoren pajisjet e punës me risqe të veqanta, vetëm nga punëmarrësit që janë përcaktuar për ato detyra? Rregullore MPMS Nr.05/2014, neni 7. Rregullorja MPMS Nr.02/2016, neni 4.3. - Verifikoni dhe sigurohuni që pajisjet me risqe të veqanta përdoren vetëm nga personeli që është përcaktuar për të punuar me ato pajisje. Dokumentet e kualifikimet dhe experiences së tyre mbahen si dokumente në arkivë. Sigurohuni që punëtorët, janë të njoftuar me risqet që e bëjnë pajisjen me risqe të veqanta, dhe procedurat e punës së igurt me ta rrespektohen plotësishtë. - Instalimet, ç'instalimet, mirëmbajtja dhe riparimi i pajisjeve të punës, a bëhet vetëm nga personeli i kualifikuar, faktet si kontratat dhe certifikatat e kualifikimeve mbahen si dokumente dëshmuese. - A janë vendosur në vendin e punës shenja, ndaluese, shenja paralajmrimi dhe obligative, Diskutoni me punëmarrësit për kuptimine shenjave dhe sigurohuni që ato i kuptojnë ato. Shembuj të shenjave janë dhënë më poshtë.    Ndalja qasja për të paautorizuar Rrezik i përgjithshëm Këmbësorët duhet ta përdorin këtë rrugë.			

4.	A është marr në konsideratë që organizimi i vendit të punës dhe pozicioni ku operatorët manipulojnë janë ergonomik? Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, neni 16. Rregullore MPMS Nr.05/2014, neni 8, shtojca 2, pika 5.1.4. Rregullore MPMS Nr.01/2020, neni 14, 17, tabela 2, pika 9.2. - Sigurohuni që ambienti i punës është i përshtatshëm dhe ergonomik. Pozicioni ku operatorët operon, a ka fushë-pamje të kuartit, xhami dhe tabletat komanduese pastrohen dhe janë të dukshme dhe të përshtatshme. - Kabina ku operuesi manipulon (shembull, kabina e kranistit, pirunjerit, dhomes komanduese), sigurohemi që është e përshtatshme/ergonomike, karrike nuk ka dëmtime, nuk është e zhytur ejt, ajëri në kabinë është i pastër dhe kondicioneri është funksional, ndriçimi është i përshtatshëm. - A është bërë një vlerësim i riskut në vendin e punës për operatorët në varsi të kohëzgjatjes së punës dhe parimeve ergonomike, (nese po) kontrolloni në vlerësimin e riskut qka është konstatuar si masa që duhet të ndërmerren për përmirësim dhe udhëzimet me konstatime merren në konsideratë për përmirësimin shkallës së sigurisë në vendin e punës. Shënim: Vendi i punës duhet të ketë hapësirë minimum 2 m² ndërsa gjërësia e lëvizjes së lirë nuk duhet të jetë më pak se 1 m.			
5.	A janë të dukshme dhe funksionale mjetet e komandimit? Rregullore MPMS Nr.05/2014, shtojca 1, 2.1, 2.2. Shtojca 2, 2.3. Rregullore (MEPTINIS) Nr.02/2020 për sigurinë e makinerive, shtojca 1, pikat 1.2.2. - Sigurohemi që makineria të futet në punë, vetëm në rastet kur pajisjet dhe komandimi më të është i sigurt, kontrollohet nëse butonat janë në kushte të mira, të pastërta dhe të dizajnuara në mënyrë të atillë që lëvizja e pajisjes së komandimit të jetë në përputhje me efektin e saj, nese identifikohen mangësi diskutoni me stafin mbase mund të merren masa të nevojshme për përmirësim. - Verifikoni butonat e komandimit, a e posedojnë shënimin sipër tyre apo në të (Shembull butoni për ndalje emergjente, indikatorin për peshën e ngritur, ekuilibrin, shpejtësinë, a është i dukshëm shënimi sipër apo në buton?).			

	- Kërkoni nga operatori që ta testojë butonin për ndalim emergjent, kur procesi nuk pengohet në një kohë të favroshme në mëyr që të verifikohet funksionaliteti i tij. - Verifikoni që makineris i funksionon sinjalizimi i nevojshëm ndriçues (sinjal paralajmërues i dëgjueshëm dhe/ose i dukshëm sa herë që makineria është gati për të filluar punën.). - Pajisjet e punës që mund të goditen nga rrufeja gjatë përdorimit, duhet të mbrohen me pajisje apo mejte të përshtatshme për tu kundërvënë efekteve të rrufesë (kontrolloni nëse makineria posedon sistemin mbrojtës nga rrufeja, dhe sigurohu që është testuar rezistenca e saj, raportin e kontrollimit dhe vlerat kufitare të sqaruara në raport ruhen në arkivë.			
6.	Operatori i makinerisë nga pozicioni i komandimit, a posedon fushë-pamje të kuartë? Rregullore (MEPTINIS) Nr.02/2020 për sigurinë e makinerive, shtojca 1, pikat 1.2.2. Rregullore MPMS Nr.05/2014, shtojca 1, 2.1, 2.2. Shtojca 2, 2.3. - Nga çdo pozicion komandimi, operatori duhet të jetë në gjendje të sigurohet se askush nuk është në zonat e rrezikut. Sistemi i komandimit duhet të jetë i projektuar dhe konstruktuar në mënyrë të atillë që vënia në punë të jetë e parandaluar derisa dikush është në zonën e rrezikut. Verifikoni që ky kushtë rrespektohet. - Para se makineria të vihet në punë duhet të jepet një sinjal vizual dhe/ose akustik i paralajmërimit. Personat e ekspozuar duhet të kenë kohë për ta lëshuar zonën e rrezikut ose për të parandaluar vënien në punë të makinerisë. Kërkoni nga operatori që të testohen sinjalet akustike të paralajmërimit, nëse ka mangësi apo zërim jo të mjaftueshëm, siguroni përmirsim të situatës. - Nëse puna duhet të kryhet nga pozicione ku fushëpamja është e reduktuar, sigurohuni që udhëzuesi /si ndihmës e kryen punën në mëyrë profesionale duke i rrespektuar procedurat dhe udhëzimet e nevojshme. Verifikoni nëse personi/ndihmësi i ka njohurit dhe kualifikimet / trajnimet e nevojshme për detyren e ngarkuar.			

7.	Kur e kërkon rasti (situata), a përdoren sinjalet e dorës dhe/ose komunikimi verbal për të udhëzuar personat që kryejnë manovra të rrezikshme? Rregullorja MPMS Nr.04/2016, shtojca 1, neni 2.2. Shtojca 2, pika 3. - <i>Manovra të tilla mund të jenë përdorimi i vinçave për lëvizjen e objekteve të rënda. Zakonisht, vetëm ndërmarrjet që punojnë në industri me risk të lartë përdorin sinjale dore dhe komunikim verbal si shenja sigurie.</i> - <i>Sigurohuni që udhëzuesi e ka njohurit e nevojshme profesionale për kryerjen e aktiviteteve të tilla duke i respektuar procedurat dhe udhëzimet e nevojshme.</i> <i>Shembuj të sinjaleve me duar:</i>  <i>Shikoni shtojcen e bashkangjitur në fund të këtij raporti. Sinjalet e koduara që duhet të përdoren.</i>			
8.	A posedojnë pajisjet e punës sistemin e komandimit për ndalim të tyre të plotë? Rregullore MPMS Nr.05/2014, shtojca 1, 2.3, 2.4. Rregullore MPMS Nr.02/2020 kërkesat min per SSHP, neni 7. - <i>Çdo pajisje në vend të punës duhet të jetë e pajisur me një sistem komandimi për ndalimin e disa ose gjitha pajisjeve të punës në varësi të llojit të rrezikut. Verifikoni testimin e pajisjeve dhe sigurohuni që ato ndalojnë plotësisht. Nëse pajisjet nuk ndalojnë apo rruga e ndalimit zgjatet, diskutoni me stafin për marrjen e masave dhe mirëmbajtjen rregullt të tyre.</i> - <i>Kur pajisja e punës ose pjesët e rrezikshme të saj kanë ndaluar, furnizimi me energji i pajisjeve në fjalë duhet ndërprerë. Verifikoni nëse rryma është ndërprerë pas testimit.</i>			

	- Komanda e ndalimit të pajisjeve duhet të ketë prioritet mbi komandat e lëshimit, kjo duhet verifikuar dhe duhet krijuar procedurat të sigurt në punë. - Kontrolloni dhe sigurohuni që pajisjet e punës e posedojnë butonin/mekanizmin për ndalim emergjent. Testoni makinerit pajisjet për funksionalitetin e tyre dhe sigurohu që stafi ka njohurit dhe trajnimin e nevojshëm. Trajnimet me nëshkrimet e punëmarrësve të trajnuar ruhet si dokument në arkivë.			
9.	A garantojnë siguri mjetet e lëviëshme të punës me puntorë në të. Përfshirë kontaktin e këtyre personave apo shtypjen e tyre me rrotat apo vet mjetin? Rregullore MPMS Nr.05/2014, shtojca 1, 3.1.2. Rregullore MPMS Nr.02/2020 kërkesat min. për SSHP, neni 8. - Nëse makineria apo pjesët lëvizëse të saj mund të krijojnë risk të veçantë, Sigurohuni që janë marrë në konsideratë të gjitha masat e sigurisë për të shmangur bllokimin dhe ndikimin negativ mbi punëtorët. Verifikohuni që procedurat / udhëzimet e sigurisë rrespektohen plotësisht. - Inspektoni kushtet e makinerisë, nëse i posedon t ë gjitha mburojat / masat mbrojtëse të parapara nga prodhuesi dhe a respektohen gjatë punës me ta.			
10.	Për mjetet e lëvizëshme me puntorë në të, ku risku i batimit / rrokullisjes është i pranishëm, a janë projektuar në atë mënyrë që të kufizoj kushtet e përdorimit? Rregullore MPMS Nr.05/2014, shtojca 1, 3.1.4. - Verifikoni që masat e sigurisë nëpërmjet strukturës mbrojtëse të projektuar për të që pajisja të mos anohet më shumë se 22 gradë dhe që lejon hapsirë të mjaftueshme rreth punëtorëve në mjetin e lëvizshëm, nëse lëvizja tejkalon 22 gradë. Shiko nëse përdorimi i pajisjes ka risk të batimit, qfar masa janë parapara nga prodhuesi dhe a zbatohen në vend. Nëse nuk ka masa të parapara apo informacioni mungon, siguroni masa të nevojshme dhe procedura të sigurisë për të parandaluar batimin e pajisjes. - Në rast se identifikoni vende të ndryshme me risk të batimit - kërkoni shkakun e tyre, mbase mund të merren disa masa teknike ose organizative për ta shmangur			

	<i>këtë risk. Diskutoni me stafin dhe ekspertë të jashtëm profesional për marrjen e masave të sigurisë.</i> - <i>Aty ku ekziston risku që një person të shtypet nëpërmjet pajisjes së punës dhe tokës, nëse pajisja batohet duhet të instalohet një sistem mbrojtës për këta persona/punëtor. (Shikoni në pajisjen/makinën, a i është instaluar sistemi i mbrojtjes dhe a posedon qëndrueshmëri në rast batimi.).</i>			
11.	Automjetet që transportojnë një ose më shumë të punësuar, a janë siguruar nga risku i përmbysjes? Rregullore MPMS Nr.05/2014, shtojca 1, 3.1.5. Rregullore MPMS Nr.02/2016, neni 4.3. - <i>Verifikoni që mjetet transportuese si pirunët janë të pajisur me strukturë rrethuese për drejtuesin e mjetit? (Si përshembull dyert, dritaret dhe mbrojtëset e nevojshme të parapara nga prodhuesi, nëse ata mungojnë apo janë jashtë funksionit merrni masat e nevojshme për rregullimine tyre.</i> - <i>Sigurohuni që mjeti posedon një strukturë të përshtatshme që parandalon përmbysjen, shembull: shikoni nëse piruni ka indikatorin njoftues për humbje të balancit, në rast se mungojnë konsultohuni me stafin dhe profesionistët që të merren masa teknike ose organizative për ta shmangur këtë risk.</i> - <i>Në raste të përmbytjes, sigurohuni që piruni/mjeti ofron hapsirë të mjaftueshme që ndërmjet tokës dhe pjesëve të caktuara të tij për personat në bord/kabinë. Në rastet e përmbytjes piruni duhet të lejoj hapsirë të mjaftueshme për shpëtimin e personave në kabinë. Nëse piruni nuk e ka strukturën e kabinës e cila do të i mbronte personat në të, merrni masa për përmirsimin e sigurisë me ato mjete.</i> - <i>A janë instaluar shenja paralajmruese për lëvizjen apo ndalimin e pirunëve dhe autmojeteve tjera, rrugët e lëvizjes për këmbësor etj. Në vazhdim shikoni nga një shembull.</i>   			

	Nuk ka qasje për automjete industriale	Automjete industriale	Shteg këmbësorësh			
12.	A janë marr masat e nevojshme të sigurisë, për pajisjet vetëlëvizëse të cilat mund të sjellin risqe për punëtorët?					
	Rregullore MPMS Nr.05/2014, shtojca 1, 3.1.6. - Sigurohuni që pajisja i posedon mekanizma për parandalimin e nisjes së pa autorizuar, shembull: çelsat apo telekomanda, sigurohen në vende të sigurta ku vetëm personat e autorizuar kanë qasje. - Verifikoni nëse operatori e aktivizon frenin siguries për parandalimin e nisjes së pajisjeve vetëlëvizëse, sigurohuni që udhëzuesit / procedurat janë në vend dhe rrespektohen plotësisht. - Sigurohuni që pajisjet i posedojnë mekanizmat të përshtatshëm për të amortizuar pasojat e përplasjes. Kur pajisja lëvizë mbi binarë ka më shumë së një njësi të cilat lëvizin në të njëjtën kohë. Shikoni mekanizmat e parapara nga prodhuesi, a janë të instaluar, shpesh ato largohen në mënyrë që të kryhet puna në një rrugë më të shkurtë. - Kontrolloni mjetet për frenim dhe ndalim të tyre kur e kërkojnë, kufizimet e sigurisë, a vihet në dispozicion mekanizma të emergjencave të cilat komandohen me sisteme automatike për frenim dhe ndalim të menjëhershëm të pajisjeve kur ka avari të pajisjes kryesore. Shembull: butoni emergjent duhet të jetë funksional, kërkon nga operatori testimin e saj. Nëse mungojnë butonat për ndalim emergjent apo janë jasht funksionit, merrni masa teknike dhe organizative për instalimin e tyre apo funksionalitetin e tyre. - Kur fushëpamja e drejtuesit të mjetit është e pamjaftueshme për të garantuar sigurinë, duhet instaluar pajisje ndihmëse të përshtatshme për të përmirësuar sigurinë. - Pajisjet e punës të projektuara për përdorim gjatë natës apo vende të errta, a posedojnë ndriçim të përshtatshëm. Kërkon testimin e llampave ndriçuese nëse ato janë funksionale apo janë të dëmtuara, bëjeni një listë inspektuese me të gjeturat nga inspektimi dhe diskutoni atë me stafin që parregullsitë e identifikuar të rregullohen dhe ata të ngjashmet të raportohen me kohë.					

	- Nëse pajisja e punës lëvizë rreth një zone të punës, duhet përcaktuar dhe respektuar rregullat e trafikut. (Shikoni linjat apo shenjat horizontale, a janë të dukshme dhe rrespektohen nga punëmarrësit, diskutoni për rëndësin e rrespektimit dhe qëllimin e saj.).			
13.	Për pajisjet të cilat kanë rrezik të ndezjes së zjarrit, a merren masat e nevojshme të sigurisë? Ligji Nr.04/L-012 për mbrojtje nga zjarri. Rregullore MPMS Nr.05/2014, shtojca 1, 3.1.6.6, Shtojca 2, 2.3. Rregullore MPMS Nr.04/2016, Aneksi I, neni 2.1.2, Aneksi IV - Sigurohuni që aparatet për fikjen e zjarrit janë të pranishëm në vendet e përcaktuara, dhe janë të gatshme për përdorim në rast nevojë, kontrolloni dhe sigurohuni që aparatet për fikjen e zjarrit e posedojnë etiketen e kontrollimit e cila duhet të kontrollohet çdo 6 muaj. - Nëse e kërkon nevoja apo pajisja duhet të posedojë shuarje automatike pëshkak rrezikut të ndezjes së zjarrit, kontrolloni funksionalitetin e saj periodikisht. - Sigurohuni që operatori është i vetëdijshëm për rrezikun, ka marr pjesë në trajnimet dhe posedon aftësinë për përdorimin e aparateve të zjarrit. (Libri i evidencës së trajnimeve me nënshkrimet e punëmarrësve në trajnime ruhet në arkivë). - Kërkoni nga disa punëmarrës të përdorin disa aparatet për fikjen e zjarrit në mënyrë praktike që të siguroheni që ato kanë njohurit për përdorimin e tyre, në të njëjtën kohë testohet edhe funksionaliteti i aparateve për fikjen e zjarrit. Gjithashtu, sigurohuni që punëmarrësit i njohin kategoritë e zjarrit dhe i posedojnë njohuritë e nevojshme se cilat aparate duhet të përdoren për secilën kategori të zjarrit. - Pajisjet e punës që mund të goditen nga rrufeja gjatë përdorimit, duhet mbrohen me pajisje apo mejte të përshtatshme për tu kundërvënë efekteve të rrufesë, raportet e inspektimit nga një trup që është i autorizuar për këto punë ruhen në arkivë ndërsa vërejtjet zbatohen. - Verifikoni shenjëzimin e aparateve për fikjen e zjarrit. Nëse mungon shenjëzimi merren masa për vendosjen e tyre, Shikoni në vazhdim një shenjë që vendoset sipër aparateve për fikjen e zjarrit.			



Fikës zjarri

14.	A janë masat e sigurisë të mjaftuara për përdorimin e sigurt të pajisjeve me telekomandë? Rregullore MPMS Nr.05/2014, shtojca 1, 3.1.6.7 dhe 3.1.6.8. - Pajisja me telekomandë duhet të ndalojë automatikisht kur ato ndodhen jashtë fushës së kontrollit, (nëse posedojnë pajisje të tilla, testoni pajisjet a ndalojnë kur janë jashtë fushës së kontrollit) - Pajisjet me telekomandë që në kushte normale do të sjellin një risk shtypje apo përplasje, pajisen me mekanizma për ruajtjen e tyre kundër këtij risku. - Siguroni mirëmbajtje të tyre adekuate periodikisht.			
15.	Pajisjet ngritëse të instaluar në mënyrë të përhershme / permanente, a janë të sigura dhe të qëndrueshme? Rregullore MPMS Nr.05/2014, shtojca 1, 3.2.1, 3.2.2, Shtojca 2, 2.3. - Pajisjet e montuara duhet të jenë të qëndrueshme dhe të fiksuara në atë mënyrë që garanton sigurinë e manipulimit me të. Vëmendje shtesë i kushtohet tensionit të ushtruar në piken e montimit apo fiksimit të strukturave. - Montimi i struktura duhet të bëhet vetëm nga personeli i kualifikuar, me përvojë, që ka makinerit/pajisjet e nevojshme për punë të tillë. Merrni raportin e montimit dhe kualifikimet e personelit që e kanë bërë instalimin e pajisjeve ngritëse. - Verifikoni që pajisjet/makinerit për ngritjen e ngarkesave e posedojnë shënimin e dukshëm të peshës maksimale që mund të ngrihet, Gjithashtu pjesët shtesë për ngritjen e ngarkesave shenjohen për të treguar në mënyrë identifikuese karakteristikat thelbësore për përdorim të sigurtë. Nëse shenjimi mungon apo			

	<i>nuk është i dukshëm, merrni masat adekuate për montrimin e shenjave dhe tabelave që tregon qartë peshën që mund të bartet/ngrihet me ato pajisje.</i> - <i>Pajisjet e punës që nuk janë të destinuara për ngritjen e personave apo që gabimisht mund të përdoren, duhet shënjohen në formë të qartë ndalesën për këtë qëllim. Inspektoni pajisjet dhe verifikoni nëse ato përdoren vetëm për atë qëllim që janë prodhuar.</i>			
16.	A merren masat e nevojshme të sigurisë për të shmangur apo zvogëluar riskun e goditjes nga ngarkesat gjatë ngritjes me pajisjet ngritëse të instaluar në mënyrë të përhershme? Rregullore MPMS Nr.05/2014, shtojca 1, 3.2.3. Rregullore MPMS Nr.02/2016, neni 4.3, shtojca V. - <i>A është instaluar pajisja në mënyrë të tillë që të zvogëlohet risku që ngarkesa të mos godas punëmarrsit apo personat e tjerë. Shikoni ngarkesa që ngritet, a ka hapsirë të mjaftueshme që të mos godas personelin apo objektin gjatë ngritjes së ngarkesës, nëse vërehet risku konsultohuni me stafin apo me ekspertë të jashtë për merjren e disa masave teknike ose organizative për ta shmangur këtë risk.</i> - <i>Nëse ngarkesa ngritet nëpërmjet një hapsire të ngushtë, sigurohuni që hapsira izolohet që askush të mos efektohet, merrni një shembull të mirë dhe të sigurtë se si duhet vepruar.</i> - <i>A është instaluar pajisja në mënyrë të tillë që të zvogëlohet risku që ngarkesa të mos rrëshqas në mënyrë të pavullnetshme apo të bjerë lirisht. Punëmarrësit që punojnë këtë natyrë të punës, duhet të posedojnë njohurit dhe kualifikimet e nevojshme!</i> - <i>Kontrolloni dhe sigurohuni që hapsirat ku këmbësorët mund të hynë në zona të rrezikshme ku ngritet ngarkesa, izolohet dhe shënjohe me shenja të dukshme në mënyrë të atillë që parandalohet qasja.</i> - <i>A janë instaluar në vendine punës shenja paralajmruese, ndaluese dhe obligative, shiko më poshtë disa shenja.</i>			

	 Ngarkesë mbi kokë  Ndalohet qasja për këmbësorë  Duhet të mbahen helmata e sigurisë  Shenja për lokacionet e rrezikshme përplasja me pengesa apo rënje e objekteve.			
17.	A janë të sigurt për përdorim pajisjet e punës për ngritjen apo zhvendosjen e punësuarve lartë? Rregullore MPMS Nr.05/2014, shtojca 1, 3.2.4, shtojca 2, 2.3. - A janë marr masat e sigursisë për parandalimin e rënjes së pajisjeve/makinerisë me anë të mjeteve të përshtatshme. Nëse nuk mund të shmangët me ndonjë masë të sigursisë duhet të instalohet një litarë pezullimi të përforcuar, i cili kontrollohet çdo ditë pune. - Shikoni, a ekziston risku i kontaktit të paqëllimshëm me objektet që mund të përbëjnë rrezik për të punësuarit, nëse identifikohet risku konsultohuni me stafin apo ekspertë të jashtëm nëse mund të merren disa masa teknike ose organizative për ta shmangur këtë risk. - Në rastet kur personat bllokohen në pajisjen ngritëse apo në rast incidenti, personat e ngujuar duhet të nxierren në mënyrë të sigurtë dhe të mos ekspozohen rreziqeve. Sigurohuni që procedurat e përpiluara janë të pranishme dhe të përditësuara, personeli për reagim emergjent e posedon trajnimet			

	<i>adekuate për këtë qëllim dhe janë të gatshëm në çdo kohë t'i përgjigjen rasteve emergjente.</i>			
18.	A janë marrë masat për të garantuar sigurinë gjatë ngritjes së ngarkesave të padrejtuara? Rregullore MPMS Nr.05/2014, shtojca 2, 4.2. - Kur dy ose më shumë njësi përdoren për ngritjen e ngarkesave të padrejtuara, shiko a instalohen/montohen në atë mënyrë që të shmangin përplasjen midis ngarkesave apo vetë pjesëve të pajisjeve të punës. Në rast se identifikoni vende me risk të përplasjes - kërkonti shkakun e tyre, mbase mund të merren disa masa teknike ose organizative për ta shmangur këtë risk. Konsultohuni me stafin apo me ekspertë të kësaj fushe. - Kontrolloni që punëmarrësit i marrin masat e nevojshme për parandalimin e pjerrtësimi apo përmbytjes së pajisjeve. Sigurohuni që plani dhe procedurat e kontrollit rrespektohen. - Nëse operatori i cili bënë ngritjen e ngarkesave me anë të pajisjeve ngritëse nuk mund ta vëzhgojë të gjithë rrugën drejtpërdrejt apo me anë të pajisjeve ndihmëse, operatori duhet të jetë në komunikim me personin kompetent për ta udhëhequr atë. Sigurohuni që punëtori si ndihmës i operatorit i ka njohurit e nevojshme, procedura e veprimit është në vend dhe rrespektohet plotësisht. - Verifikoni, a janë mbajtur trajnimet e nevojshme për operatorin dhe ndihmës-operatorin, certifikatat e trajnimeve dhe kualifikimet e tyre mbahen edhe në arkivën e ndërmarrjes.			
19.	Përdorimi i pajisjeve të punës për punë të përkohëshme në lartësi. Rregullore MPMS Nr.05/2014, shtojca 2, pika 5.1, 5.1.7 dhe 5.4. Rregullore MPMS Nr.02/2016, neni 4.3. - Nëse përdorimi i pajisjeve të punës për punë të përkohëshme në lartësi nuk mund të bëhet në mënyrë të sigurtë dhe në kushte të përshtatshme ergonomike, duhet të përzgjidhet pajisja e punës që ofron kushte të sigurta të punës. Kontrolloni në vend, nëse pajisjet mirëmbahen rregullisht dhe janë në kushte të mira, të pa dëmtuara.			

	- Masave kolektive ju jepet përparsi ndaj masave individuale të mbrojtjes. - Përmasat e pajisjeve duhen të jenë të përshtatshme për natyrën e punës, në bazë të shpeshtësisë së kalimit, lartësisë dhe kohëzgjatjes së përdorimit. Kjo zgjedhje duhet të lejojë evakuimin në rast rreziku të menjëhershëm, kalimin në secilën drejtim nga mjeti për akses dhe platformave, dyshemeve dhe kalimeve nuk duhet të shkaktojë ndonjë risk shtesë për rënie. Nëse vëreni që akseset janë të bllokuara apo shkaktojnë risqe shtesë, diskutoni me stafin dhe paralajmëroni për rreziqet e mundëshme nga situatë të tilla, pra pastrami i vendit të punës nga beturinat është i domosdoshëm. - Puna në lartësi, në platforma të varura në litarë dhe me pajisje të pozicionimit duhet të përmbajë të paktën dy litarë të ankoruar veç e veç: një si mjet hyrje, zbritje dhe mbështetje (litarë pune) dhe tjetri si litarë rezervë (sigurie). - A janë instaluar në vendin e punës shenja paralajmëruese, ndaluese dhe obligative, shiko më poshtë disa shenja.  Ngarkesë mbi kokë  Ndalohej qasja për këmbësorë  Duhet të mbahen rripat e sigurisë  Shenja për lokacionet e rrezikshme përplasja me pengesa apo rënje e objekteve			
20.	Pajisjet e instalimeve elektrike, a janë të projektuara dhe të ndërtuara në përputhje me normat specifike në mënyrë të tillë që të mos shkaktoj rrezik për zjarr dhe shpërthime? Rregullore MPMS Nr.01-2020 kërkesat minimale për SSHP, neni 6, 27.			

	Rregullore MPMS Nr.02/2016, neni 4.3. - Sigurohuni që punëmarrësit janë të mbrojtur nga kontakti i drejtpërdrejt apo tërthorasi me instalimet elektrike, inspektori, panelet elektrike, kabujt e zhveshur, dhe pajisje tjera me energji, a posedojnë izolimet e përshtatshme. Nëse gjinden mangesi, merrni masat e nevojshme për eliminimin e faktorve të rrezikut. - Sigurohuni që pajisjet mbrojtëse të instalimeve elektrike, janë të përshtatshme për tensionin dhe e posedojnë mbrojtjen e duhur të instaluar nga personel i kualifikuar. - Verifikoni që pajisjet mbrojtëse dhe instalimet elektrike, janë të mbrojtura nga kushtet e jashtme. Inspektori në ambientin e jashtëm pajisjet dhe instalimet elektrike, a posedojnë mburojë të përshtatshme që gjatë kohës me të reshura të mos vije deri tek deportimi i ujit në instalime, nëse risku identifikohet merrni masa adekuate për të shmangur këtë risk. - Mirëmbajtja e aparaturave dhe pajisjeve elektrike kryhet vetëm nga personat me ekspertizen dhe shkathtesin përkatëse. - Aty ku ekziston rreziku, a janë instaluar shenjat e nevojshme të sigurisë, shembull më poshtë:  Mos prek  Rrezik: Elektricitet  Duhet të mbahen dorëzat e sigurisë			
21.	Mirëmbajtja dhe gjendja e rregullt e ashensorit, a bëhet në përputhje me udhëzimet të dhëna nga instaluesi/prodhuesi i ashensorit? Rregullore Nr.05/2018 për sigurinë e ashensorëve në përdorim, neni 3. - Sigurohuni që në rastet kur ashensori ka defekt, fiket dhe izolohet që të mos përdoret përdoret dhe shenjohe me shenja paralajmëruese. Inspektori vendin dhe izolimi, a garanton siguri të plotë?			

	- Kontrolloni, a janë të shënuar numrat e telefonit të emergjencës dhe të kujdestarit brenda kabines së ashensorit dhe janë të dukshme? - Verifikoni librin e evidencës së ashensorit, a janë shënuar të gjitha të dhënat e mirëmbajtësit, shpëtuesit dhe kujdestarit të ashensorit, nëse libri mungon apo të dhënat nuk janë shënuar, Ata duhet të sigurohen sa më parë të jetë e mundur.  Rrezik i përgjithshëm			
	KONTROLLIMI I DOKUMENTEVE / NË ZYRË			
	* Nëse keni një ofrues të jashtëm të shërbimit të SSHP-së ose ekspertin tuaj për SSHP, takohuni me të/ata. * Ftoni përfaqësuesin e të punësuarve të marrë pjesë në kontrollimin e dokumenteve. * Pas vizitës së realizuar shpjegoni vëzhgimet tuaja të mira dhe të këqija nga vizita juaj në lokacion. * Tregohuni miqësorë, sqaroni dhe këshillojini për detyrimet që obligohemi në përmirësimin e situatës së sigurisë në vendin e punës. * Përfundoni takimin duke dhënë një rekomandim përfundimtar të sigurisë dhe fushat për përmirësim.			
22.	A është siguruar dokumentacioni përcjellës i pajisjeve të punës të punësuarve në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe në gjuhë të tjera të kuptueshme lidhur me përdorimin, funksionimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e tyre të sigurtë? Rregullore Nr.05/2014 Kërkesat minimale për përdorimin e pajisjeve të punës, neni 5 Rregullore (MEPTINIS) Nr.02/2020 për sigurinë e makinerive. Pika: 1.7.4.			

	- Verifikoni manualët e pajisjeve nga prodhuesi mbi mënyrën e përdorimit të pajisjeve të punës, a janë të pranishme, nëse manualët mungojnë kërkon nga prodhuesi i makines apo përfaqësuesi udhëzimet/manualin e atyre pajisjeve, nëse kjo është e pa arritshme duhet të merr masat e sigurisë me ekspertë të fushave përkatëse përpilimin e procedurave të sigurisë për manipulim të sigurtë më ta. - Verifikoni që manualët dhe udhëzimet, janë të përkthyer në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe në gjuhë të tjera të kuptueshme për punëmarrësit që i përdorin, mirëmbajnë ato, nëse manualet të gjinden vetëm në një gjuhë (shembull vetëm në gjuhën angleze), duhet që të marr masa për përkthimin në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, të cilën punëmarrësit e kuptojnë. <i>Shënim: Të gjitha makineritë duhet të shoqërohen me udhëzime në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës. Udhëzimet që e shoqërojnë makinerinë duhet të jenë ose 'udhëzime origjinale' ose 'përkthim i udhëzimeve origjinale', në të cilin rast përkthimi duhet të shoqërohet me udhëzime origjinale.</i>			
23.	A realizohet mirëmbajtja teknike e mjeteve, pajisjeve, si dhe korigjimi sa më i shpejtë që është e mundur të çfardo defekti ose mangësie, që e cenon sigurinë dhe shëndetin e të punësuarve në vendin e punës? Rregullore MPMS Nr.04/2014 kërkesat min për SSHP, neni 5. Rregullore MPMS Nr.01/2020 kërkesat min për SSHP, neni 3, 4. - Pajisjet e punës të destinuara për të parandaluar ose eliminuar rreziqet duhet kontrolluar rregullisht. Kontrolloni raportet e inspektimeve dhe mirëmbajtjes, a janë realizuar kontrollat periodike. Parregullsitë e identifikuar, a janë eliminuar në afate të shkurta. Nëse testimet/raportet mungojnë, organizoni kontrollime periodike me staf adekuatë. - Nëse gjatë inspektimit në teren janë verejtur parregullësi, mbeturina në vendin e punës, pa-pasteri në pajisjet dhe mejetet e punës, këshilloni punëmarrësit dhe organizoni pastrimin e vendit të punës periodikisht. (Rrugët e lëvizjes drejt daljeve emergjente dhe daljeve të tjera, në çdo kohë duhet të jenë të pastërta pa pengesa.).			

	- Verifikoni dokumentet me anë të të cilave të punësuarit dhe përfaqësuesit e tyre, janë informuar me të gjitha masat që janë marrur në lidhje me sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës.			
24.	Nevoja e inspektimeve specifike të pajisjeve të punës a bëhen nga personat kompetent? Rregullore MPMS Nr.05/2014, neni 6. Rregullore MPMS Nr.02/2020 kërkesat min për SSHP, neni 5, 6. - Për punëtorët që bëjnë inspektime dhe testime speciale, verifikoni dokumentet e tyre, kualifikimin, certifikaten dhe eksperiencën e nevojshme, nëse kontrollimet nuk janë realizuar apo janë realizuar nga persona jo adekuat, organizoni trajnime specifike me stafin dhe me trajnues të jashtëm të fushave përkatëse dhe ruajeni dokumentacionin / certifikatat e trajnimit si dëshmi. - Kontrolloni rezultatet e inspektimeve, a janë regjistruar dhe ruajtur si dokumentacion dëshmues, nga kontrollet/inspekimet e bëra. (Nëse me dispozitat e legjislacionit në fuqi nuk paraishkojnë, ndryshe rezultat e kontrollimeve periodike mbahen gjatë gjithë kohës sa pajisja është në funksion. Kontrollat e kryera speciale mbahen të paktën për 5 vite.). Verifikoni dokumentet/raportet, a janë të pranishme? - Verifikoni raportet e kontrollit / inspektimit cilat ishin masat e nevojshme që ishin ndërmarr për tu siguruar që puna me atë pajisje është e sigurtë. Gjithashtu, verifikoni, a janë eliminuar faktorët e rrezikut, nëse raportet mungojnë apo ska historik për mirëmbajtjet organizoni monitorim dhe kontrollime të rregullta. Raportet ruhen si dokumentacion në arkivë. - Kontrollat e kryera dhe raportet nga organiza të jashtme (nese ka), a është shoqëruar me një kopje të rezultateve apo dukumente që kanë lidhje me kontrollin e funidit. Merrni një shembull të mirë dhe sqaroni rëndësin e raportimit për të garantuar sigurinë në vendin e punës.			
25.	A janë të pajisur me pajisje mbrojtëse personale të punëusarit sipas vlersimit të riskut? Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, neni 16. Rregullore 02/2016 kriteret minimale për pajisje personale mbrojtëse, neni 4, 5, 7.			

	- A është bërë një vlerësim i riskut në vendin e punës, (nëse po) a janë paraparë në të karakteristikat që çdo pajisje personale duhet të posedojë në mënyrë që të zvogloj riskun në vendin e punës. Nëse nuk është bërë vlersimi i risku merrni masat e nevojshme për vlersimine riskut për secilën pozitë të punës me anë kompanive të licencuar nga MPMS. - Verifikoni nëse punëmarësit janë të pajisur me PPM të nevojshme, kontrolloni nënshkrimet në librin e evidencës që vërteton pranimin e PPM-ve. Sigurohu që kanë marr pjesë në trajnimet e organizaur për ta nga ekspertët e fushës. - Sigurohu që bëhet zëvendësimi i rregullt për secilën pajisje që dëmtohet, vjetërsohet, verifikoni në librin e evidencës. <i>Shënim: Gjatë vizitave gjithmonë jepni shembullin tuaj, përdorni PPM-të në varësi të riskut që ekzistonë në lokacion/vendet e punës!</i>			
26.	Pajisjet vetëlëvizëse të punës, a përdoren nga punëmarrësit me kualifikimin e duhur? Rregullore MPMS Nr.05/2014, shtojca 2, 3.1. Rregullore MPMS Nr.02/2016, neni 4.3. - Pajisjet vetëlëvizëse të punës, duhet të drejtohen vetëm nga punëmarrësit e trajnuar, me ekperiencë dhe që kanë një kualifikim përkatës. Verifikoni dokumentet, certifikatat a janë të pranishme, sigurohuni që kanë trajnimet dhe njohurit e nevojshme. - Verifikoni planin në të cilën janë shenjur masat kufizuese, a efektohet personeli, a është e nevojshme përditsimi për të garantuar sigurinë në vendin e punës. Sigurohuni që punëmarrësit e dine kuptimine shenjave të vendosura dhe rreziqet që mund të vijnë si pasojë e mos rrespektimit të tyre.			
27.	A janë marrë masat për të garantuar sigurinë për ngritjen e ngarkesave me anë të pajisjeve ngritëse? Rregullore MPMS Nr.05/2014, shtojca 2, 4.1. Rregullore (MEPTINIS) Nr.02/2020 për sigurinë e makinerive, shtojca 4.3. - Pajisjet e punës për ngritjen e ngarkesave duhet të përdoren në mënyrë të tillë që të sigurojnë qëndrueshmëri të pajisjes së punës gjatë përdorimit të saj në të			

	<i>gjitha kushtet e parashikueshme, përfshirë natyrën e tokës. Sigurohuni që dokumentacioni i studimit (gjeologjik dhe gjeomekanik) është në vend. Pozicionimi i pajisjes është vlersuar nga studimi i ekspertëve, raporti i studimit është zbatuar në tërësi, nëse dokumentet mungojnë apo nuk janë bërë studime, organizoni masat e nevojshme ekspertët e fushave përkatëse dhe raportet ruajini si dëshmi. Kërkoni raporte për çdo studim, insoektim që bëni.</i> <i>- Verifikoni procedurat në rastet kur ngriten ngarkesat, a janë çekur aty veprimet e punëmarrësve apo persona të tjerë të mos jenë të pranishëm poshtë ngarkesave të varura përveq rasteve kur prezencat tyre është e nevojshme për funksionimin e mirë të punës së pajisjeve.</i> <i>- Pajisjet shitesë duhet të ruhen në mënyrë të tillë që garanton mos-dëmtimin dhe duhet shenjuar. Nëse gjatë vizitës tuaj keni vërejtur që vendi i deponimit të pajisjeve nuk është i përshtatshëm, apo ekziston risku i dëmtimit diskutoni me punëmarrësit për marrjen e masave organizative apo teknike për ta shmangur riksun.</i> <i>- Verifikoni nëse janë bërë testimi dhe certifikimi i litareve/zinxhirve që përdoren për ngritjen e peshave. Nëse nuk ka testime apo certifikimeve ju ka skaduar afati i vlefshmëris, merrni masa për certifikimin tyre dhe raportet ruani në arkivë si dokumente dëshmuës.</i> <i>- Sigurohuni që kryeni kontrole periodike për të gjitha pajisjet në shërbim nga personeli adekuat dhe për çdo inspektim / kontroll kërkoni raportet e inspektimit, sigurohuni që vërejtjet merren parasysh për eliminimin faktorëve të rrezikut.</i> <i>Shënim 1: për pajisjet që përdoren për ngritjen e personave: Personat mund të ngriten vetëm me anë të pajisjeve të punës dhe pjeseve shitesë të parashikuar për këtë qëllim, pa cenuar dispozitat e ligjit 04L-161.(shikoni komfirmimet, qëllimin se për qka janë të projektuar ato pajisje, nuk lejohet që pajisjet e dizajnuara për qëllime tjera, të përdoren për ngritjen – uljen e njerzive, përveq nëse kryhen veprime të përshtatshme për grantimin e sigurisë në përputhje me ligjet dhe praktiken kombëtare që parashikojnë mbikqyrjen e duhur).</i> <i>Shënim 2: Certifikimi i testimit të pajisjeve ngritëse mund të bëhet nga një trup i licencuar për inspektim dhe certifikim e cila garanton për qëndrueshmërin dhe peshën që mund ta bartin pajisjet ngritëse.</i>			
--	--	--	--	--

28.	A garantohet siguri për ngritjen e ngarkesave të pa drejtuara në rast të ndërprerjes së energjisë? Rregullore MPMS Nr.05/2014, shtojca 2, 4.2.6 dhe 4.2.7. - Nëse si pasojë e një ndërprerje të plotë apo të pjesëshme të enërgjise, pajet e punës të projektuara për ngritjen e ngarkesave të pa drejtuara nuk mund të mbajnë ngarkesat e tyre, duhet të merrë masat e duhura për të shmangur ekspozimin e punëmarrësve apo çdo personi tjetër nga çdo risk që buron nga kjo situatë. Verifikoni planin operues, procedurat e shënuara dhe faktet që dokumentojnë se janë komunikuar paralajmrimet dhe risqet. Verifikoni dhe sigurohuni që për këto situatë punëmarrësit janë trajnuar se si duhet vepruar. Gjithashtu, sigurohu që punëmarrësit e posedojnë njohurit e nevojshme për këtë risk. - Përdorimi i pajisjeve të punës të projektuara për ngritjen e ngarkesave të pa drejtuara duhet të ndalet kur kushtet meteorologjike përkeqsohen deri në pikën që rrezikojnë përdorimin e sigurtë të pajisjeve dhe ekspozojnë punëmarrësit ndaj risqeve. (Në planin e ngritjes duhet të bëhet një studim për pëshen e ngritur, zonën operuese, kushtet e ngritjes kur mund të punohet dhe kur jo. Në rastet me erë të fortë puna duhet të ndalet, dhe kjo duhet të jetë e cekur në planin e ngritjes, nëse mungojnë procedurat apo planin operues, nuk është i kompletuar, merrni masat e sigurisë për përpilimin / kompletimin e procedurave dhe komunikimin e tyre me punëmarrësit.			
29.	A është bërë një vlersim risku për punën në lartësi me platforma të varura në litarë? Ligji Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, neni 16. Rregullore MPMS Nr.05/2014, shtojca 2, pika 5.1.3. Rregullore (MEPTINIS) Nr.02/2020 për sigurinë e makinerive, shtojca 4.3. - Puna në lartësi me platforma të varura në litarë me pajisje për pozicionimin mund të kryhet vetëm në rrethana kur vlersimi i riskut tregon se puna mund të kryhet në menyrë të sigurtë dhe ku nuk justifikohet përdorimin i pajisjeve të tjera të sigurt.			

	- Në vlerësimin e riskut (nëse është bërë), a janë cekur masat që duhet të ndërmerren për të garantuar punë të sigurtë me platformen e varur, dhe a zbatohen në vend nga punëmarrësit. - Verifikoni nëse janë bërë testimi dhe çertifikimi e litareve/zinxhirve që përdoren për ngritjen e peshave. Nëse nuk ka testime apo çertifikimeve ju ka skaduar afati i vlefshmëris, merrni masa për certifikimin tyre dhe raportet ruani në arkivë si dokumente dëshmues.			
30.	Montimi i pajisjeve ngritëse të instaluar në mënyrë të përhershme / permanente, a bëhet vetëm nga personat kompetent? Rregullore MPMS Nr.05/2014, shtojca 1, 3.2.1, 3.2.2, Shtojca 2, 2.3. - Montimi i struktues duhet të bëhet vetëm nga personeli i kualifikuar me përvojën që ka, makinerit/pajisjet e nevojshme për punë të tillë. Verifikoni praninë e raportit të montimit dhe kualifikimet e personelit që i kanë bërë instalimet/montimet, nëse personeli nuk është i kualifikuar për punë të tilla, diskutoni me stafin dhe ekspertët e jashtëm për marrjen e masave adekuate të sigurisë, dhe evidentoni gjitha vërejtjet dhe masat e marrura në raporte. - Pajisjet e punës që mund të goditen nga rrufeja gjatë përdorimit, duhet të mbrohen me pajisje apo mejte të përshtatshme për tu kundërvënë efekteve të rrufesë (kontrolloni nëse makineria posedon sistemin mbrojtës nga rrufeja, dhe sigurohu që është testuar rezistenca e saj, raportin e kontrollimit dhe vlerat kufitare të sqaruara në raport ruhen në arkivë.			
31	A kanë punëmarrësit njohuri për rreziqet e zjarrit? Rregullore MPMS Nr.05/2014, shtojca 1, 3.1.6.6, Shtojca 2, 2.3. Ligji Nr.04/L-012 për mbrojtje nga zjarri. - Punëmarrësit, a janë të njohur me rrezikun e zjarrit, verifikoni librin e evidencës së trajnimeve, a kanë marr pjesë në trajnime të punësuarit për mbrojtje nga zjarri, dhe sigurohuni që posedojnë njohurit e nevojshme për fikjen e zjarrit, kategorit e zjarrit dhe përdorimin e aparateve për fikjen e zjarrit. - Diskutoni me punëmarrësit dhe këshilloni ata për rreziqet e zjarrit nëpërmjet ekspertëve të fushave.			

	- Siguroni punëmarrësve PPM dhe mjetet e nevojshme për mbrojtje dhe fikje të zjarrit. Të gjitha pikat e cekura më lartë duhet mbahet evidence.			
32.	Gjendja e rregullt e ashensorit, a bëhet në përputhje me udhëzimet të dhëna nga instaluesi/prodhuesi i ashensorit? Rregullore MPMS Nr.05/2018, neni 3. - Verifikoni, a janë realizuar inspektime të rregullta dhe inspektimet e jashtëzakonshme të nevojshme të ashensorëve, kontrolloni raportet raportin e inspektimit, qfarë është konstatuar nga inspektimi, a janë eliminuar sipas afateve kohore vërejtjet. Nëse vëreni vonesa apo shmangëje të përgjegjësive, merrni masa organizative dhe teknike për përmirësim të situates. - Verifikoni dokumentin e vlersimit i riskut në vendin e punës (nëse është bërë), dhe a janë përfshirë masat mbrojtëse të sigurisë për punë me ashensorët, masate parapara a janë zbatuar dhe dokumentuar? - Verifikoni kontratën e nënshkruar me një operator ekonomik kompetent për mirëmbajtjen e ashensorëve, nëse kontrata nuk është nënshkruar merrni masat e nevojshme për nënshkrime kontrates sipas rregullores në fuqi. - Verifikoni a është nënshkruar një kontratë për shpëtimin e personave të ngujuar në ashensor me një shpëtues që i përmbush kërkesat nëse kontrata nuk është nënshkruar merrni masat e nevojshme për nënshkrime kontrates sipas rregullores në fuqi. - Verifikoni librine e evidencës së ashensorit, a shënohen të gjitha të dhënat e mirëmbajtësit, shpëtuesit dhe kujdestarit të ashensorit?			
33.	A realizohet inspektimi periodik i ashensorit? Rregullore Nr.05/2018 për sigurinë e ashensorëve në përdorim, neni 9. - Inspektimi periodik i një ashensori përfshinë të gjitha kontrollet dhe testet e nevojshme me të cilat trupi i emëruar verifikon sigurinë e përdorimit të ashensorit. Verifikoni raportet e inspektimit periodik a janë të pranishme dhe të evidentuara. - Verifikoni dhe sigurohuni që kryhet inspektimi periodik të paktën një herë në vit i ashensorit vërejtjet e konstatuara nga inspektim, a janë eliminuar?			


	- <i>Ashensorët duhet të inspektohen rregullisht nga trupi i emëruar për vlerësimin e konformitetit. Mirëmbajtësi i ashensorit merr pjesë në inspektimin periodik.</i>			
--	--	--	--	--

Sinjalet e koduara që duhet të përdoren:


3. Sinjalet e koduara që duhet të përdoren

Vërejtje paraprake:

Tërësia e sinjaleve të koduara në vijim nuk i paragjykon kodet e tjera që përdoren në nivel të komunitetit dhe që përdoren për manovrimet e njëjta në disa sektore:

Domethënia	Përshkrimi	Ilustrimi
A. Sinjalet e përgjithshme		
FILLO Vëmendje Fillim i komandës	të dyja duart zgjaten horizontalisht me shuplakat e duarve të kthyer përpara	
NDALO Ndërprerje Përfundim i lëvizjes	dora e djathtë ngritet përpjetë me pëllëmbë të kthyer përpara	
PËRFUNDO operacionin	dora e djathtë ulet teposhtë me pëllëmbë të kthyer përpara	

B. Lëvizjet vertikale		
NGRIT	dora e djathtë ngritet përpjetë me pëllëmbë të kthyer përpara dhe e bën një rreth ngadalë	
UL	dora e djathtë ulet teposhtë me pëllëmbë të kthyer kah brendia dhe e bën një rreth ngadalë	
DISTANCË VERTIKALE	duart tregojnë distancën përkatëse	

C. Lëvizjet horizontale		
LËVIZ PËRPARA	të dyja duart ulen teposhtë me pëllëmbë të kthyer përprjetë, ndërsa parakrahët bëjnë lëvizje të ngadalshme drejt trupit	
LËVIZ PRAPA	të dyja duart ulen teposhtë me pëllëmbë të kthyer teposhtë, ndërsa parakrahët bëjnë lëvizje të ngadalta larg trupit	
NË TË DJATHTË të sinjalizuesit	dora e djathtë zgjatet pak a shumë horizontalisht me pëllëmbë të kthyer teposhtë dhe ngadalë bën lëvizje të vogla në të djathtë	
NË TË MAJTË TË sinjalizuesit	dora e majtë zgjatet pak a shumë horizontalisht me pëllëmbë të kthyer teposhtë dhe ngadalë bën lëvizje të vogla në të majtë	
DISTANCA HORIZONTALE	duart tregojnë distancën përkatëse	
D. Rreziku		
RREZIK Ndalje emergjente	të dyja duart ngriten lart me pëllëmbë të kthyer përpara	
SHPEJT	të gjitha lëvizjet më shpejtë	
NGADALË	të gjitha lëvizjet më ngadalë	